



Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

LAJMËRIM PARAPRAK

për publikim të Thirrjes publike numër 01/2023 për parashtrim të kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi 2021-2027)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmërojnë të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se në kuartalin e katërt të vitit 2024 do të shpallet Thirrje publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi për periudhën 2021-2027).

Qëllimi i IPARD Programit 2021-2027 është përmes masave përkatëse për mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural të përmirësohet konkurrenca e prodhimit bujqësor dhe sektorit bujqësor-ushqimor, përmes harmonizimit të tyre me standardet e Bashkimit Evropian dhe arrijës së ambientit të qëndrueshëm jetësor dhe zhvillim socio-ekonomik në mjediset rurale përmes nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjes së mundësive për punësim.

Mjetet financiare nga IPARD Programi 2021-2027 në lidhje me realizimin e kësaj Thirrje publike nga 2024 dedikohen për masat në vijim:

➤ Masa 7 – Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit edhe atë për sektorët prioritarë në vijim:

- Prodhimi alternativ bujqësor (i cili nuk mbështetet sipas masave 1 dhe 3),
- Përpunimi i produkteve bujqësore alternative (i cili nuk mbështetet sipas masave 1 dhe 3),
- Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve,
- Mbështetja e aktivitetëve artizanale,
- Mbështetja e shërbimeve për popullsinë rurale, vetëm nën-sektorët e mëposhtëm:
 - Shërbimet e qëndrimit dhe të kujdesit (shtëpi për të moshuarit, për rehabilitim etj.);
 - Shërbimet e kujdesit ditor për fëmijët.
- Shërbimet mbështetëse në bujqësi, vetëm nënsektori i mëposhtëm:
 - Krijimi dhe promovimi i shërbimeve veterinarë.
- Mbështetja e turizmit rural.

Thirrja publike e ardhshme e IPARD Programit 2021-2027 ofron mundësi të shtuara për sa i përket llojit të investimeve, një volum më të madh përdoruesish potencialë ose në përgjithësi mbështet investimet në diversifikimin e fermave dhe zhvillimin e bizneseve të vendosura në zonat rurale në drejtim të përmirësimit të performancave të përgjithshme, produktivitetit ekonomik dhe konkurrencës së ndërmarrjeve.

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2021-2027 udhëzojnë lidhjen paraprake të kontratës së shfrytëzuesve potencial me Agjencinë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në pajtim me kushtet e kontraktuara paraprakisht. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës kryejnë personat e autorizuar nga Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë së Veriut për udhëheqje, zbatim dhe kontroll të IPARD dhe Bashkimit Evropian.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e mbështetjes financiare nga IPARD Programi 2021-2027 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e mbështetjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga Instrumenti për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian.

Shpallja do të zgjasë së paku **45 ditë** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në gazetën ditore.

VËREJTJE: Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesave, duke përfshirë dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit e mjeteve sipas masës përkatëse nga IPARD Programi 2021-2027 do të azhurnohen dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë në periudhën deri në shpalljen e Thirrjes publike 2/2024.

Informacione më të hollësishme në lidhje me llojet e investimeve, kriteret për fitimin e mbështetjes financiare dhe shuma e mbështetjes, të interesuarit mund t'i marrin në Agjencinë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

Telefoni: 02 3097-460
Faksi: 02 3097-454
e-mail adresa: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk
www.pa.gov.mk

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave Sektori për udhëheqje me IPARD
Telefoni: 02 3134-477 lok: 113, 114 dhe 115
e-mail adresa: info@ipard.gov.mk
www.ipard.gov.mk

Agjencia për nxitje të zhvillimit në bujqësi
Telefoni: 047 228-330
Faksi: 047 228-370
www.agencija.gov.mk çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Prodhuesit bujqësorë të interesuar mund të marrin informacion për përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesave, si dhe këshilla praktike për aplikim, pa pagesë në qendrat rajonale të Agjencisë për nxitjen e zhvillimit në bujqësi. (Në faqet e internetit të institucioneve kompetente publikohet lista kontaktuese e qendrave rajonale dhe personave kompetentë).

